



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 919 Prot.

Ballsh, më 29.02. 2024

VENDIM

NR. 10, DATË 28 / 02 / 2024

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË OBJEKTIT “NDËRTIM I UJËSJELLËSIT TË FSHATRAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE ARANITAS”,
MIRATIMIN NË PARIM PËR SHPRONËSIMIN E PRONAVE QË MUND TË PREKEN DHE ZHDËMTIMIN E DËMEVE QË MUND TË LINDIN NGA ZBATIMI I KËTIJ PROJEKTI**

Mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronja “b”, e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik , i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e projektit të zbatimit me objekt “Ndërtim i ujësjellësit të fshatrave të Njesisë Administrative Aranitas”;
2. Miratimin në parim për shpronësimin e pronave që mund të preken dhe zhdëmtimin e dëmeve që mund të lindin nga zbatimi i këtij projekti;
3. Kompensimi financiar dhe procedurat lidhur me shpronësimin e pronave dhe zhdëmtimin e dëmeve që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

